



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD Elvin GJEVORI

Dr. Ejona ISUFAJ

Maj / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr.482, datë 03.10.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.372 datë 23.10.2020 Urdhër Nr.373 datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit periodik	VBA Nr. 65, datë 28.09.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit akademik/ 2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	<ul style="list-style-type: none">• 2018 - 2019 : 7 PAE/ 2 PAK• 2019 - 2020 : 7 PAE/ 2 PAK• 2020 - 2021 : 7 PAE/ 2 PAK• 2021 - 2022 : 6 PAE/ 3 PAK

18	Numri i studentëve:	2018-2019; 6 studentë; 2019-2020; 7 studentë; 2020-2021; 5 studentë; 2021-2022; 5 studentë;
19	Komente / të tjera:	Sipas urdhërit të licensimit programi i studimit realizohet me 90 kredite, me kohëzgjatje 1.5 vite, nuk kemi urdhër riorganizimi; Numri i studentëve është dhënë në total për të dy profilet, vlen të theksohet se profili Studime Mesdhetare vetëm në vitin akademik 2019-2020 ka regjistruar 1 student, në vitet e tjera nuk studentë të regjistruar;

TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka filluar aktivitetin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë". "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" është akredituar institucionalisht me urdhër Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.

Me Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011, mbështetur në VKA Nr. 198 dt. 24.06.2011, "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" ka riorganizuar programet e saj të studimit. Me Urdhër të Ministrit Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në VKA Nr. 303 dt 13.01.2012, Institucioni është akredituar institucionalisht dhe në programet Bachelor. Me Urdhër të Ministrit Nr 278 dt 19.05.2017, "Miratimin e Statutit të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" institucioni funksionon si Universitet. Institucioni është akredituar instucionalisht me VBA Nr. 105, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë"

Programi i studimit MP në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane është hapur me urdhër Nr. 482 datë 03.10.2011 nga Ministri i Arsimit dhe është i organizuar me kohëzgjatje 2 semestra, 60 ECTS dhe ofrohet në gjuhën shqipe.

Ky program studimi është akredituar për herë të parë me urdhër nr. 291 datë 11.07.2012 të Ministri i Arsimit dhe akredituar periodikisht me vendim të Bordi të Akreditimit nr. 65, datë 28.09.2018.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Eivin Gjevori dhe Dr. Ejona Isufaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Znj. Majlinda Demireli, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë të zhvillua në datat **11 dhe 12 Tetor 2022** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra me programin e studimit Master Profesional në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 65, datë 28.09.2018, datë janë:

1. Institucioni, të realizojë një studim të plotë të tregut të punës për të konkluduar nëse tregu i punës ka nevojë për profilin "Studime mesdhetare", vlerën e tij në kontekstin vendas dhe se si ky program studimi mund t'i adaptohet nevojave të tregut.
2. Institucioni, të standardizojë dhe përditësojë syllabuset si dhe të zbatojë politika monitorimi nga Njësia bazë përgjegjëse dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave.
3. Në syllabuset e lëndëve, të identifikohen e detajohen format e mësimdhënies (leksione, seminare, etj) duke përcaktuar dhe llojet e vëllimin e literaturës përkatëse.
4. Duke marrë parasysh specifikën e fushës së programit të studimit, Institucioni, të rrisë ndërkombëtarizimin e programit të studimit nëpërmjet bashkëpunimeve me institucione akademike dhe profesionale ku studentët të mund të bëjnë studime dhe praktikë, e cila mund të jetë edhe një mënyrë efektive për t'a bërë programin më tërheqës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për rekomandimin e parë, GVJ vlerëson se është **përbushur kryesisht**. Specifikisht, institucioni ka kryer një studim siç i është rekomanduar, por situata me regjistrimin e studentëve vijon problematike. Kështu ose studimi nuk është bërë siç duhet ose të dhënat e përfuara nga ai nuk janë përdorur siç duhet. Sido që të jetë, numri i ulët i regjistrimeve vijon të jetë shqetësim objektiv. Bazuar në sa më sipër edhe në këtë raport është lënë një rekomandim për këtë çështje.

Rekomandimi 2 dhe 3 janë plotësuar plotësisht.

Rekomandimi 4 është plotësuar gjithashtu, sidomos duke patur parasysh vështirësitë me të cilat është përballur ndërkombëtarizimi gjatë kufizimeve të COVID-19.

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.04.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 44/6 Prot, datë 11.04.2023. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" më datë 03.05.2023, njofton nëpërmjet sistemit, nëpërmjet shkresës me Nr.717 Prot datë 03.05.2023, "Komente për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm", ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Drafti merr formën e Raportit Final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional MP në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH) i cili është i hartuar hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, përcaktohet qartë vizionin dhe misionin e UMSH që të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit nëpërmjet programeve të studimit të ofruar nga ky institucion.</p> <p>Roli dhe misioni i UMSH, bazuar në dokumentacionin e institucionit, është që t'u ofrojë studentëve jo vetëm një edukim cilësor akademik, por edhe të kontribuojë në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike të shoqërisë shqiptare. Programi i studimit Master i Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile, mbështetur në Statutin dhe Planin Strategjik të UMSH, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti i UMSH, Ev.2 Plani strategjik</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e studimeve shoqërore-politike, me ndikim në rajon e më gjerë, duke ju ofruar një edukim cilësor në partneritet me institucione ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti i UMSH,</i> <i>Evidenca 2 Plani strategjik</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së	<p>Programi i studimit MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile, është një program studimi i ciklit të dytë të studimeve i hartuar në përputhje me rregulloren e institucionit dhe të njësisë kryesore dhe Planin strategjik të institucionit, që synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi për kërkim</p>

<p>Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>shkencor në fushën e studimeve shoqërore-politike.</p> <p>Në përputhje me Statutin, programi i studimit ka për qëllim zhvillimin e dijeve dhe përgatitjen e studentëve në nivel bashkëkohor nëpërmjet aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Programi i studimit synon të përgatitë specialistë të aftë dhe të kualifikuar jo vetëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, por dhe në kërkimin shkencor.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti,</i></p> <p><i>Evidenca 2 Plani strategjik,</i></p> <p><i>Evidenca 3 Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program pajis studentët me aftësi të mira teorike dhe praktike. Programi i studimit është në përputhje me zhvillimet strategjike jo vetëm kombëtare por edhe ato rajonale pasi ofron ekspertizë specifike në lidhje me zhvillimet politike dhe proceset integruese të rajonit (mesdheut) dhe vendit. Me hapjen e negociatave, të cilat do të jenë të gjata e me nevojë për ekspertizë teknike, të diplomuarit e këtij programi, mund të gjejnë një treg të favorshëm pune.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit ka vite që ofrohet nga IAL, ka kaluar një proces të mëparshëm vlerësimi dhe është në përputhje të plotë me interesat kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe dokumentat strategjitë të IAL.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standarçi I.2</p>	
<p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin, qëllimin e institucionit si dhe me strategjinë afatshkurtër dhe afatgjatë të tij duke mbajtur në konsideratë nevojat e tregut të punës dhe duke pasuaruar programin mësimor me lëndë të cilat</p>

<p>specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>plotësojnë nevojat për këto kërkesa.</p> <p>Programi i studimit mban në konsideratë zhvillimet ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Pozicioni i Shqipërisë dhe marrëdhëniet e saj rajonale si dhe me vendet e Bashkimit European përditësohen dhe pasqyrohen në programin e studimit.</p> <p>IAL ka një staf me tituj dhe grada si dhe me eskperiençë të gjatë akademike dhe profesionale (kryesisht në diplomaci / ish ministra e ish ambasadorë) e cila është një vlerë e shtuar e rëndësishme sidomos për një program studimit master profesional.</p> <p>Në tërësi, programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Europiane, Studime Mesdhetare është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivat e programit të studimit janë të përshtatura dhe të integruara me strategjinë për zhvillim të institucionit të cilët janë të matshëm dhe të realizueshëm prej tij. Programi mundëson studimin teorik në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, për t'i përgatitur studentët si specialistë të aftë që të punojnë në fushat përkatëse</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPMN</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane dhe Studime Mesdhetare ka si objekt studimin dhe formimin praktik/profesional duke i trajtuar ato në përputhje me zhvillimet globale dhe në përgjigje të nevojave të tregut të punës në vend dhe rajon.</p> <p>Ky program është pjesë e kurrikulës të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe përputhet me fushën akademike e kërkimore të kësaj njësie kryesore.</p> <p>Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë, në kuadrin e prioriteteve të integritit të Shqipërisë në Bashkimin European. Ky program studimi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve europiane në aspektin e teorive të integritit, të drejtën europiane, politikave publike, teorive të administratës, historisë së qytetërimit mesdhetar, sistemet politike të Mesdheut si dhe politikave të Bashkimit European në Mesdhe.</p>

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, është një program studimi i Ciklit të Dytë me 60 kredite, i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën shqipe, i organizuar me një kohëzgjatje normale 1 vite (2 semestra). Në bazë të shqyrtimit të dokumentave (Rregullore e UMSH dhe departamentit) konstatohet që organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje të plotë me fushat e drejtimet akademike të UMSH. Objektivat e programit janë në përputhje me objektivat e Fakultetit dhe Departamentit të.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Numri i vogël i studentëve të diplomuar në këtë program studimit e bën të vështirë aplikimin e strukturuar të një politike të tillë. Gjithësesi, GVJ vereu që UMSH ka një politikë të strukturuar për angazhimin e alumni përgjatë gjithë vitit akademik ku ofrohen dhe hapësira për zhvillim të vazhdueshëm profesional.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin të cilat kanë gjithashtu kapacitetet e duhur për ta ofruar dhe monitoruar atë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në përgjithësi, me sa u vu re nga vitita në institucion dhe takimet me aktorë të ndryshëm, UMSH inkurajonte bashkëpunimin midis stafit. Duke qenë dhe universiteti është relativisht i vogël, bashkëpunimi dhe komunikimi është i natyrshëm dhe organik. Teksa universiteti zgjerohet, instancat duhet të tregojnë kujdes dhe të ndermarrin masa proaktive që ky lloj bashkëpunim të mos venitet.</p> <p><i>Evidenca 11. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare,;</i></p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare, publike e jo, si dhe profesionale ku studentët mund të ndermarrin praktikën e tyre profesionale. Këto marrëveshje shfrytëzohen edhe për të përthithur zërin e tregut të punës dhe për të mundësuar përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Gjithashtu, duke qenë se ky program ka një numër të vogël studentësh, këto marrëveshje janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e tyre.</p> <p><i>Evidenca 11. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera</i> https://www.umsh.edu.al/c/113/nderkombetarizimi</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me</p>	<p>Institucioni paraqiti një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në RVB dhe gjatë vizites me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, publike dhe jo, akademike dhe profesionale me të cilat bashkëpunon në nivele të ndryshme dhe ku studentët mund</p>

<p>institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>të kryejnë praktikat e tyre. Marrëveshjet, me qa sa ishim ne gjendje te kuptonin nga teksti i tyre, ishin te dobishme dhe ne shërbim te ketij programi. Bazuar në këto të dhëna konkludojmë që ky kriter plotësohet.</p> <p><i>Evidenca 11. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera</i> https://www.umsh.edu.al/c/51/bashkepunime</p>
---	--

<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Programi MP në marrëdhënie ndërkombëtare ka një strategji zhvillimi i cili është bazuar në analizën, në rang departamenti, mbi ecurinë e programit ndër vite. Departamenti në bashkëpunim me NJSBCZHK analizon problematikat e vërejtura mbi programin dhe ndërmerr hapat përkatëse, ne vizitë u informuar që në përgjethësi universiteti ka një përjasje konservatore dhe ndryshimet bëhen pas konsultimeve të gjera e të gjata dhe ndryshimet bëhen rrallë.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPMN</i></p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat, duke patur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve, janë mëse të mjaftueshme për realizimin e komponentit praktik të programit të studimit.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky program studimi është pjesë e kurrikulës të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”, në kuadrin e prioriteteve të Integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.</p> <p>Ky program është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve europiane në aspektin e teorive të integritimit, të drejtën europiane, politikave publike, teorive të administratës, historisë së qytetërimit mesdhetar, sistemet politike të Mesdheut si dhe Politikave të Bashkimit Europian në Mesdhe.</p> <p>Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 1 vit akademik ka 60 javë mësimore në auditor ➤ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor <p>Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë</p> <p>Në tërësi lëndët e programit janë të përshtatshme me qëllimet e programit dhe me objektivat e tij. Gjithashtu lëndët kanë tituj të përshtatshëm, të qartë dhe që përshkruajnë në mënyrë korrekte tematikën e lëndës.</p> <p><i>Temat që identifikohen në silabuse duhet të shoqërohen edhe me disa fjali orientuese dhe sqaruese për studentët si dhe me lërximet përkatëse me faqe specifike.</i></p>

	<p>Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Për leksionet: 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit ▪ Për Seminaret: 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit ▪ Për Praktikën Profesionale: 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit ▪ Provimi përfundimtar: 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil Studime Mesdhetare dhe Studime Evropiane ka qëllim që të formojë specialistë me orientim praktik në fushat studimore të mësipërme. Sipas raportimeve dhe nga vizita, ishte e qartë që Universiteti synonte të krijonte specialistë me formim praktik që mund të integroheshin lehtësisht në tregun e punës. Universiteti gjithashtu ka angazhuar edhe një numër pedagogësh të jashtëm me eksperiencë praktike në diplomaci (ish ministra e ish diplomatë) si mësim-dhënës në këtë program.</p> <p>Kurrikula e këtij përmban disiplina bazë formuese- përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (A) gjithsej 6 ECTS; karakterizuese – përgatitje për disipinën shkencore (B) gjithsej 25 ECTS; ndërdisiplinore/integruese-nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) gjithsej 14 ECTS; plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) gjithsej 6 ECTS si dhe detyrime përmblylëse (E) gjithsej 9 ECTS.</p> <p>Përsa i përket përshtatshmërisë së programit me kërkesat e tregut të punës, <i>profili studime mesdhetare vijon të paraqitet problematik pasi, edhe nga diskutimet që patëm me stafin, e gjetëm të veshtirë të identifikonim mundësi reale punësimi në tregun shqiptar në këtë orientim.</i> Fakti që shumë pak studentë regjistroheshin në këtë profil është indikator i këtij problemi.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p>

	<p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Siç u shprehëm më sipër në program përfshihet praktika profesionale me 5 ECTS dhe teza e diplomës me 8 ECTS.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së</p>	<p>N/A</p>

<p>paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky institucion nuk ka status të veçantë.</p> <p>Studentet që ndjekin programin MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Evropiane; Studime Mesdhetare kanë si detyrim të kenë përfunduar studimet universitare në nivel bachelor e të kenë grumbulluar 180 ECTS.</p> <p>Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me ligjin 80/2015, si edhe aktet nënligjore në fuqi, dhe pasi është bërë kontrolli i dosjes me dokumentacionin e kërkuar. Ky program mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe garanton përfitimën e dijeve, aftësive e shkathtësive në përputhje me nevojat e tregut të punës. Pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me specifikat e programit, mundësitë akademike, nevojat e tregut si dhe mundësitë infrastrukturore të institucionit. Bazuar në rregulloret e programeve të studimit institucioni shpall kriteret specifik të pranimi.</p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare,</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria</p>	<p>Nuk ka ende kodifikim edhe pse VKM ka dalë që në maj 2022. VKM nr 310 datë 11.05.2022. IAL –të kanë të drejtë të paraqesin në MAS kodet respektive të programeve deri në periudhën shkurt – mars 2023.</p>

përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.									
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A								
Konkluzione	<i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret/kërkesat ligjore si përsa i përket organizimit të programit, ndarjes në ECTS ashtu edhe kriteret e pranimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2												
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.												
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësia kryesore dhe njësitë bazë përbërëse të saj kanë staf akademik dhe ndihmës akademik në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nën-ligjore në fuqi. Institucioni ka zhvilluar procesin e akreditimit Institucional në kuadër të akreditimit periodik, me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 62, datë 18.12.2020 është akredituar për 6 vite me afat vlefshmërie deri më 17.12.2026.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vitin akademik 2021-2022, ka 40 staf akademik gjithsej, ku 30 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 10 pedagogë me kohë të pjesshme.</p>											
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table>	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	PAE	PAK	Prof. Dr.	2	0	Prof. As. Dr.	2	2		
Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	PAE	PAK										
Prof. Dr.	2	0										
Prof. As. Dr.	2	2										

personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Dr. / PhD.	13	7
MSc.	13	1
Në total	30	10
Totali	40	

Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Politke dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	1	0	1	0
Prof. Asoc.	0	1	0	1	0	0
Dr./PhD.	4	4	6	3	6	1
Msc.	6	0	5	0	4	0
Totali	11	5	12	4	11	1

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (FSHJMN) është riorganizuar sipas Urdhërit të MAS Nr. 268, datë 16.05.2022, në Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane me përbërjen si më poshtë:

1. Departamenti i së Drejtës;
2. **Departamenti i Shkencave Politke dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;**
3. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;
4. Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave;

Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse

Bazur në RVB si dhe nga vizita në institucion, GVJ vëreu se njësia kryesore, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë për


<p>për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>programet master dhe mbikqyrjen e procesit mësimor ka caktuar një koordinator si përfaqësues në zyrën master. Koordinatori kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarive mësimore të këtyre programeve. Duke qenë që programi ka shumë pak student aktiv, ky rregullim, sipas GVJ, është i përshtatshëm dhe eficient</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikqyrjen e programit të studimit përmbushin kriteret ligjore për numrin e stafit me tituj dhe grada si dhe përsa i përket akteve të tjera të brendshme rregullatore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjen e vetë vlerësimit si dhe vizitën në institucion, GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë dhe i vënë në dispozicion të studentëve të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve realizohet duke u mbështetur në aktet e brendshme të UMSH dhe rregulloret e njësive bazë, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës.</p> <p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare - përgjegjës për programin e studimit programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. GVJ u informua gjithashtu në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion se të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me</p>

	<p>programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve dhe materialeve që hidhen në portalin e studentit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, UMSH ofron programe studimi të organizuara në module e të vlerësuara në kredite ECTS. Plani mësimor për programin e studimit MPMN pasqyron zhvillimin e programit në 1 vit akademik, me 60 kredite. Plani përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave në zbatim të udhëzimeve të MAS (2 semestra me nga 15 javë).</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, programin e studimit mund ta ndjekin studentë të cilët zotërojnë së paku diplomën “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të UMSH, përfshirë rregulloren e programit të studimit MPMN dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve realizohen nga një komision duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga MAS dhe kriteret të veçanta që vendos institucioni. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH dhe shprehet e përmbledhur në një udhëzues të posaçëm.</p> <p><i>Evidenca 15. Broshura e studimeve MPMN;</i></p> <p><i>Evidenca 16. Udhëzuesi i transferimeve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion mbi njohuritë që ofrohen e rezultatet e pritshme të mësimnxënies. Specifikisht, në</p>

<p>informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>planin mësimor të programit pasqyrohen të gjithë elementët në përputhje me aktet nënligjore në fuqi si: emërtimi i lëndës, semestri kur zhvillohet, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit në ECTS, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminarë, ushtrime dhe seanca të praktikave të zhvilluara jashtë auditorit, raporti leksion/seminar, ushtrime, praktika mësimore, mënyra e kontrollit të dijeve si dhe totali i krediteve.</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të UMSH, në koordinim me njësinë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, monitorojnë nëpërmjet sondazheve, vëzhgimeve e takimeve periodike cilësinë e mësimdhënies dhe kënaqshmërinë e studentëve. Gjithashtu zhvillohen edhe takime më të rralla, por periodike, me aktorët e interesuar të tregut të punës për të marrë pershtypjet e tyre mbi aftësitë e të diplomuarve dhe nevojat për përmirësime. Te gjitha këto informacione administrohen nga njësi bazë, e cila nëse konkludon që ka nevojë për ndryshime ndjek hapat e përcaktuara në rregullore për t'i kërkuar ato.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi është në përputhje me kriteret ligjore, i strukturuar si dhe përmban objektiva formues të qartë e të përshtatshëm për ciklin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi përmban lëndë që u mundësojnë studentëve njohuri mbi zhvillimet rajonale (kryesisht evropiane dhe mesdhetare) në përputhje me emërtimin e programit. Lëndët - në varësi të profilit të zgjedhur - së bashku me praktikën profesionale, i mundësojnë atyre aftësim praktik për patur karrierë profesionale. Studentët e interesuar për të vijuar master shkencor ap më tej, e kanë këtë mundësi.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kategorive përcaktëse me ngarkesën përkatëse. Programi i studimit përmban disiplina bazë formuese – përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme (A) gjithsej 6 ECTS; karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (B) gjithsej 25 ECTS; ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) gjithsej 14 ECTS; plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) gjithsej 6 ECTS si dhe detyrime përmbyllëse (E) gjithsej 9 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Praktika profesionale është pjesë e planit mësimor të programit të studimit dhe pasqyrohet si veprimtari plotësuese e kategorisë D. Praktika ka 6 ECTS ekuivalente me 150 orë gjithsej e shtrirë në 3 javë, gjatë semestrit të dytë.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik</p>	<p>Raportet midis formimit teorik dhe praktik të programit të studimit burojnë nga objektivat e tij. Objektivat kryesore të programit lidhen me dhënien e njohurive mbi studimet rajonale sipas profileve përkatëse.</p>

<p>mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Vlerësimi me ECTS i lëndëve në programin e studimit mundëson krahasimin e njohurive mes programeve të ngjashme e lehtëson transferimin e krediteve/studimeve. Institucioni gjithashtu inkurajon mobilitetin e studentëve sidomos kur financohen nga BE. Në tërësi, GVJ vëren se raporti midis formimit teorik dhe praktik u mundëson studentëve kompetenca dhe aftësi që përshtaten me kërkesat e pozicioneve të punës.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, njësia bazë dhe njësia kryesore, në fillim të çdo viti akademik kanë një proces ku analizojnë të dhënat e përfuara nga analiza e vitit paraardhës si dhe mënyrat se si ato mund të reflektohen, ndër të tjera, në përditësimin e silabuseve. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ vëren se ky proces ishte i mirë-rregulluar. Gjithësesi, GVJ gjithashtu vëren se një numër jo i vogël lëndësh kishin tekste bazë të vjetra që kishin nevojë për përditësim ndërsa disa sylabuse, sidomos në profiling e studimeve mesdhetare, nuk kishin tekste bazë fare.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi synon t'iu ofrojë studentëve aftësim praktik nëpërmjet mësimdhënies dhe lidhjes me aktorët e tregut të punës që të jenë të aftë të analizojnë fenomenet e marrëdhënieve ndërkombëtare me fokus në zhvillimet evropiane dhe mesdhetare. Programi synon formimin e specialistëve të rinj të aftë të punojnë ose të vijnë specializim të mëtejshëm në fushat ku kanë interes e që lidhen me studimet rajonale.</p> <p>Siç e thamë edhe më sipër profile i studimeve mesdhetare mbetet i 'dyshimtë' përse i përket mundësisë për punësim në Shqipëri e në tërësi dobishmërisë si profil.</p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPMN</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e</p>	<p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit synon punësimin e studentëve duke u fokusuar kryesisht në aftësimin e tyre praktik. Nga ato pak studentë që kanë përfunduar këtë program, thuajse të gjithë janë të punësuar edhe pse jo gjithmonë në profilin e tyre të diplomimit. Gjithashtu, ky program studimi – qoftë ligjërish, qoftë nga përmbajtja – i lejon të diplomuarve vijim e studimeve të mëtejshme. <i>Evidenca 3. Strategjia e</i></p>

tregut e punës.	zhvillimit të programit MPMN			
Konkluzione	Struktura, lëndët, syllabuset dhe përmbatja e tyre janë në tërësi në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Duhet bërë më shumë punë që tekstet bazë të jenë për të gjitha lëndet dhe ato të jenë të përditësuara			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UMSH ka marrëdhënie të strukturuar bashkëpunimi me aktorët e tregut të punës, kryesisht për praktikën mësimore dhe për të krijuar lidhje për studentët për të lehtësuar punësimin e tyre të mëtejshëm. Përsa i përket programeve mësimore, fakultetet dhe njësitë bazë zhvillojnë takime, kryesisht një herë në vit për të identifikuar nevojat e tyre dhe për t'u pëpjekur për t'i reflektuar në sylabuse të cilat 'rifreskohen' në fillim të vitit akademik. <i>Evidenca 9. Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidenca 11. Marrëveshjet e bashkëpunimit mes UMSH e Universiteteve e Institucioneve të tjera</i>

<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes së UMSH, nga senati në njësinë bazë. Nga vizita në institucion GVJ gjithashtu vëreu se studentët ishin të përfshirë edhe në sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Specifikisht, GVJ vëreu se mendimit të studentëve zhvillohet kryesisht nga Njësia e Cilësisë (NJSBCZHK) dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës së bashku me pedagogun tutor të cilët përfshijnë studentët në diskutime përmes fokus grupeve dhe takimeve të ndryshme. Gjetjet nga këto takime i përcillen njësisë që i përket programit. Edhe pse ky sistem dukej i strukturuar dhe funksional në nivel institucional, <i>GVJ nuk ishte në gjendje të identifikonte ndryshime/ përmirësime specifike në program që kishin ardhur si pasojë e ndërveprimit me partnerët e tregut të punës.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Gjurmimi i studentëve alumni dhe angazhimi i tyre periodik mbikqyret nga ZKSK në bashkëpunim me njësitë e tjera administrative dhe njësitë bazë në UMSH. Në këtë kuadër UMSH ka dhe një formular tip që plotësohet nga alumni për të krijuar dastabazën e të dhënave. GVJ u informua se, bazuar në përpunimin e të dhënave të marra nga formulari, UMSH disponon të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve, për mbledhjen e të cilave ndihmon formulari i studentit Alumni.</p> <p><i>GVJ nuk identifikoi raste specifike ku programi i studimit të ketë reflektuar sugjerimet e rrjeteve apo shoqatave të profesionistëve në silabuset apo programin e studimit.</i></p> <p>Evidenca 17. Formulari i studentit Alumni</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UMSH ka marrëdhënie të konsoliduara me aktorët e tregut të punës të cilët, ndër të tjera angazhohen edhe në procesion e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Ndoshta pvr shkak të programit të studimit me një numër të kufizuar studentësh, GVJ nuk vëreu raste specifike se si ky bashkëpunim ishte reflektuar në programin e studimit nën vlerësim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me Profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare është në përputhje me objektivat dhe mundësitë e institucionit. Siç u tha më sipër, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare zotëron aftësitë programatike (stafrin) që të ofrojë lëndët bazë dhe ndërdisiplinore për këtë program studimi. Gjithashtu, duke qenë që UMSH është pjesë e rrjetit të universiteteve të Mesdheut, fokusi në studime mesdhetare është në përputhje me objektivin strategjik të institucionit për tu kyçur në marrëveshje bashkëpunimi me IAL në rajonin e mesdheut. Së fundmi, IAL ka edhe objektiv mundësimin e të diplomuarve në tregun e punës gjë për të cilën MP është dizenuar edhe në ligjin e arsimit të lartë.</p> <p><i>Evidenca 9. Analiza e tregut të punës</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Programi Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare përbëhet nga lëndët dhe modulet e tyre të cilat kanë qëllimet, objektivat, dijet dhe aftësitë profesionale që studentët pritet të përfitojnë në përfundim të studimeve. Programi mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe synon përfitim të dijeve, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Programi synon formimin e shprehive të veçanta nëpërmjet lëndëve bazë, formuese, karakterizuese që synojnë pajisjen e studentëve me njohuri bazë shkencore dhe praktike në studimet rajonale. Pedagogët e lëndëve i ndërtojnë vetë silabuset e tyre në bazë të udhëzimeve ligjore në fuqi e pa kufizime programatike apo përmbajtësore.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i></p> <p><i>Evidenca 9. Analiza e tregut të punës</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master</i></p>

	<i>Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Numri i studentëve në këtë program studimi është i limituar dhe kohëzgjatja e tij vetëm 1 vit. Këto dy elementë e bëjnë të vështirë krijimin e programeve të strukturuar për përfshirjen e studentëve në programe kërkimore aq më tepër që ky program studimi ka karakter kryesisht aplikativ. Gjithësesi, zhvillimi i temës së diplomës është momenti kryesor kur studentët, nëse kanë dëshirë, mund të angazhohen në kërkim shkencor nën udhëheqjen e një pedagogu. Për këtë process, UMSH ka struktura dhe rregullore të posaçme të dedikuara për të orientuar dhe ndihmuar studentët.			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>Proçesi i hartimit të buxhetit në UMSH është gjithëpërfshirës dhe bazohet sidomos në kërkesat e njëjësive bazë. Buxheti i institucionit përsa i përket strukturimit dhe zbatimit të tij, rregullohet në Statut dhe Rregulloren e UMSH.</p> <p>Burimet financiare kryesore të institucionit janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të studevntëve, aktiviteteve me të tretë dhe financime nga projektet kryesisht ndërkombëtare.</p> <p>Duke qenë që programi ka një munër të ulet studentësh, nga pikpamja financiare ai “del me humbje” dhe mbulohet nga buxheti i IAL pasi konsiderohet si fushë prioritare kërkimore. Të gjitha aktivitetet, kryesisht mësimore, në lidhje me programin mbulohen financiarisht nga IAL.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se programi i studimit është në përputhje me objektivat e institucionit, menaxhohet me efektivitet nga njësia bazë dhe ka në dispozicion burimet e nevojshme për të qenë efektiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të theliuara, ndërkombëtarizim dhe kërkim

shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit është me një numër të kufizuar studentësh si dhe i nje karakteri profesional/aplikativ, kështu që përse i përket kërkimit shkencor nuk ka shumë peshë specifike. Gjithësesi, njësia bazë – si në rregullore, plan pune dhe strategji kërkimi – ka një fokus në kërkimin shkencor të cilin pedagogët e reflektojnë në syllabuset e lëndëve duke formësuar sidomos rezultatet e të nxënit, konceptet themelore dhe objektivat e lëndës.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Njësia bazë kishte interes dhe përjasje proaktive për të bashkëpunuar me aktorët e tregut të punës sidomos përse i përket praktikave dhe punësimit të të diplomuarve. Gjithësesi, duke patur parasysh edhe karakterin e programit të studimit si dhe nevojat e tregut të punës në Shqipëri, nuk ka patur kërkesa specifike për studime specifike. Gjithësesi, nëpërmjet projekteve me financim kryesisht nga BE, njësia bazë ka qenë aktive në projekte studimore me karakter kryesisht teorik/akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Fokusi i programit të studimit është praktika dhe jo aq shumë formimi teorik me qasje kërkimore. Gjithësesi, njësia bazë – në kuadër të programeve të tjera që ajo ofron – në bashkëpunim me njësinë kryesore kanë një program të strukturuar të kërkimit shkencor, botimeve dhe konferencave që organizojnë dhe/ose marrin pjesë. Në të gjitha këto elementë edhe studentët e programit të studimit nën shqyrtim mund të marrin pjesë, pavarësisht – siç thamë më sipër – se kërkimi shkencor nuk është fokus kryesor i studimeve të tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Studentët që janë diplomuar në këtë program studimi janë kryesisht të punësuar. Nga analiza që GVJ zhvilloi mbi një pjesë të syllabuseve të programit studimit vuri re fokusin mbi analizën e arritjeve të studentit gjatë gjithë semestrit. Në përfundim të lëndës/modulit, stafi akademik bën vlerësimin e nivelit të aftësive</p>

	<p>dhe kompetencave të fituara të studentëve në përfundim të çdo semestri dhe evidenton rezultatet e arritura nga studentët siç është analiza e statistikave të sezonit të provimit. Gjithashtu, njësia bazë organizon në fund të vitit akademik rishikimin të programit të studimit në bazë të ecurisë së studentëve në çdo lëndë/modul për nivelin e kompetencave dhe aftësive që ata kanë fituar. Ky proces i strukturuar rrit mundësitë që studentët e diplomuar të kenë aftësi konkurues në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	N/A			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	N/A			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se për atë që i përshkruhet karakteristik aplikativ të programit të studimit, ai ofron mundësi për kërkim shkencor dhe në këtë kuadër bashkëpunim me tregun e punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës II	përgjithësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga analiza e DVV, RVB si dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve përcaktohen në Rregulloren e Organizimit të UMSH, Rregulloren e Fakultetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Në përputhje me rregulloret e sipërpërmendura të cilat janë konform akteve ligjore dhe nën-ligjore është hartuar plani mësimor dhe syllabuset individuale të lëndëve.</p> <p>Pas analizës së syllabusesve, GVJ vëren dhe konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve të përdorura në programin e studimit janë si vijon: leksionet/ seminarët/ labororet/ detyrat e grupit/ detyrat e kursit, seanca të praktikave profesionale, tema e diplomës etj.</p> <p>Sipas planit mësimor rezultojnë në auditor, përkatësisht sipas formave të mësimdhënies, orët e mëposhteme në total:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 201 orë leksione; - 210 orë seminare - 0 orë ushtrime / laboratore; - 0 orë forma të kontrollit të vazhdueshëm; - 120 orë praktika profesionale; - 30 orë diploma/provim formimi; - 570 orë gjithsej;
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Për natyrën ndërdisiplinare të programit të studimi me ndërthurje midis marrëdhënieve ndërkombëtare, shkencave politike, studimeve rajonale etj. programi përdor metoda të ndërthurura të mësimdhënies e vlerësimit që lidhen kryesisht me metodikat e ndryshme të lëndëve në varësi të fushës kryesore të cilave ato i përkasin.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	

	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UMSH i kushton vëmendje të veçantë studentëve me aftësi ndryshe duke ofruar bursa dhe infrastrukturën e nevojshme që ato të ndjekin procesin mësimor. Në këtë program studimi nuk ka studentë të regjistruar me aftësi ndryshe.</p> <p>Siç jemi shprehur edhe në standarde të tjera më sipër e më poshtë, institucioni mbështet personelin në përmirësimin e aftësive didaktike nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve. Specifikisht, UMSH ka hartuar kalendar aktivitetesh “Program trajnimi dhe kualifikimi 2020-2021” nëpërmjet të cilit stafi akademik trajnohet periodikisht për ato çështje që ka interes dhe nevojë. Po aq e rëndësishme stafi akademik nxitet të marrë pjesë në aktivitete shkencore si konferenca dhe botime artikujsh të cilat pritet të reflektojnë edhe në mësimdhënien e tyre. Për këtë stafi akademik në fund të çdo viti plotëson edhe forlumarët e vetë-deklarimit.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p> <p><i>Evidenca 22. Programi i trajnimeve 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ofron një ndërthurje shumë të mirë midis stafit të ri, atij me eksperiencë, teoricienëve dhe praktikuesve. Nga ky këndështrim, GVJ konstaton se stafi akademik është një nga pikat e forta të këtij programi studimi. UMSH ka angazhuar personel akademik të kualifikuar, me tituj e grada duke filluar nga akademikë të njohur, teoricienë të diplomacisë dhe ish-diplomatë të respektuar në përputhje me lëndët që ata zhvillojnë dhe në përmbushje të kërkesave ligjore.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se stafi akademik, duke patur parasysh edhe lidhjet e tyre profesionale, i mundësojnë studentëve praktika apo angazhime profesionale - përtej detyrimeve ligjore - si instrument për aftësimin e tyre praktik.</p> <p>Bazuar në analizën e DVV, RVB si dhe vizitën në instituion,</p>

<p>tyre.</p>	<p>për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në mësimdhënie 9 pedagogë PAE dhe PAK me tituj e grada si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 pedagog me titullin Prof. Dr; - 2 pedagog me titullin Prof.Asoc; - 5 pedagog me gradën Dr.; - 0 pedagogë me Master Shkencor; <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Siç do të bëhet e qartë edhe nga analiza e detajuar e fushës 6 “Sigurimi i cilësisë së programit të studimit”, UMSH ka një proces kapilar e të institucionalizuar të vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Gjithashtu, në këtë proces, në mënyrë integrale dhe në çdo hallkë përfshihen studentët e programit të studimit. Specifikisht, NJSBCZHK bashkëpunon me fakulttin për të ngritur grupet ad-hoc të punës (GVB), ku një anëtar është nga departamenti përkatës, në funksion të vlerësimit periodik të programit të studimit dhe rregullores së tij. Ndërkohë njësia bazë vlerëson syllabuset dhe zbaton rekomandimet e NJSBCZHK të bazuara në pyetësorët me studentët.</p> <p><i>Evidenca 20. Plan pune i NJSBC për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK</i></p> <p><i>Evidenca 23. Procedura e punës me fokus grupet</i></p> <p><i>Evidenca 21. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar se në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 80/2015, UMSH ka ngritur, me urdhër të rektorit, Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, si njësine kryesore në nivel institucional për sigurimin dhe promovimin e cilësisë. Kjo njësi vlerëson (nëpërmjet një plani vjetor pune) e raporton periodikisht pranë rektorit dhe zyrës së burimeve njerëzore gjetjet e tyre mbi veprimtaritë mësimore dhe kërkimore të institucionit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBCZHK, në përmbushje të kompetencave dhe detyrave,</p>

<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>bashkëpunon me njësitë kryesore duke ngritur grupe pune të cilat verifikojnë veprimtarinë mësimore, mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p><i>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka njësi dhe politika si dhe rregullore dhe udhëzime dedikuar ngritjes, konsolidimit dhe zbatimit të një sistemi të efikas dedikuar garantimit të formimit akademik e praktik të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga analiza e DVV, RVB si dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren e UMSH, Rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit të cilat janë në dispozicion të studentëve.</p> <p>Kryesisht studentët njihen me mënyrat e vlerësimit dhe testimit nëpërmjet prezantimit të lëndës dhe syllabueve në javën e parë të semestrit nga pedagogët. Të gjitha materialet e nevojshme, përfshirë syllabuset, janë të aksesueshme në portalin e studentëve</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Duke reflektuar kërkesat e Rregullores së Programit të studimit, në syllabuset e lëndëve janë parashikuar format dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Kryesisht, testimi i njohurive dhe shkathtësive realizohet nëpërmjet provimeve të ndërmjetme.</p>

profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	përfundimtare, detyrave të shtëpisë, të kursit, ushtrimeve, punëve të laboratorit, etj. Testimet mund të zhvillohen me shkrim ose me gojë në varësi të specifikave të lëndëve.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Tërësia e metodave të mësipërme siguron një vlerësim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës dhe jo penalizues për studentët. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i> <i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 18. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit përsëritës</i> <i>Evidenca 27. Udhëzues për studentët 2021-2022</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka procedurë të qarta, të përshtatshme e gjithëpërfshirëse për vlerësimin e dijeve dhe shkathtësive të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përfundimisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga analiza e DVV, RVB si dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se vlerësimi i shkathtësive akademike të studentëve bazohet në principin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mësimore dhe është shumatorja e disa metodave të tilla si: pjesëmarrja, detyrat e kursit, provimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar. Kryesisht, pesha e secilit vlerësim është si vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10% • Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 20% • Testim i ndërmjetëm 30% • Provimi përfundimtar 40%

	<ul style="list-style-type: none"> • Totali 100% <p>Vlerësimi i vazhdueshëm i mundëson pedagogut që të ketë ‘nën kontroll’ situatën gjatë gjithë semestrit dhe i jep mundësi studentëve që të grumbullojnë pikë gjatë gjithë semestrit. Në këtë mënyrë edhe pedagogu edhe studenti kanë mundësi që gjatë semestrit të ‘rikalibrojnë’ qasjen e tyre ndaj lëndës duke rritur mundësitë e suksesit.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ vuri re se provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen kryesisht me shkrim dhe metoda e korigjimit është standard. Në këtë program studimi GVJ nuk gjeti evidencë të përdorimit të sistemeve elektronike të provimit dhe korigjimit. Megjithatë GVJ u informua që institucioni gjatë periudhës së COVID-19 ka përdorur testimet online me Google Forms ose Microsoft Teams.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve dhe shkathtësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve të cilët përbëhen nga jo më pak se 2 anëtarë ku njëri është titullari i lëndës. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës para zhvillimit të provimit, miratohet nga përgjegjësi i grup-lëndës ose përgjegjësi i njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se, siç pohohet edhe ne RVB, provimet zhvillohen me sekretim. Identifikimi i studentëve në klasë dhe procesi i sekretimit zhvillohet nga sekretaria mësimore e cila është gjithashtu përgjegjëse për të verifikuar statusin e studentit mbi përmbushjen e detyrimeve paraprake për zhvillimin e provimit. Provimi monitorohet nga pedagogët e lëndës dhe studentët i marrin rezultatet e vlerësimit kryesisht brenda 3 ditëve nëpërmjet LMS.</p> <p>Bazuar në një udhëzues të brendshëm, referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se në korigjimin e provimit pedagogu jep komentet përkatëse që mbështesin</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik</p>	

shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	vlerësimin total. Korrigjimi bëhet sipas tabelës së pikëve që ndodhet në fund të tezës në të cilën shkruhen edhe komentet.			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në tërësi teza e provimit merr në konsideratë nivele të ndryshme njohurish nga më të thjeshtat tek më të vështirat duke i dhënë mundësi studentëve të të gjitha niveleve të arrijnë rezultatit në përputhje me angazhimin e tyre. Teza kryesisht përmban tiplologji pyetjesh si vijon:			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përshkruese; - Pyetje shpjeguese; - Pyetje vlerësuese. <p>Studentët kanë mundësinë e 'ankimimi't të rezultatit sipas Rregullores së UMSH dhe Rregullores së fakultetit. Ankimimi shqyrtohet nga komisioni fillestar i provimit. Nëse komisioni gjykon se ka vend për ndryshime, ia komunikon notën e re studentit dhe e reflekton në sistem. Nëse studenti vijon mosdakodësinë, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim në sekretarinë mesimore. Në këtë rast ngrihet një komision tjetër me miratimin e Dekanit i cili është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë. Në përfundim të procesit, teza së bashku me zgjidhjen depozitohet në departament. Si rregull, provimet me shkrim ruhen nga pedagogu 1 vit pas përfundimit të provimeve.</p>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i></p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca 27. Udhëzues për studentët 2021-2022.</i></p>			
Konkluzione	GVJ vëren se procesi i vlerësimit është i mirë-rregulluar, transparent, me nivele të ndryshme dhe të përshtatshme kontrolli, që ofrojnë mundësinë për një vlerësim të drejtë të dijeve dhe shkathësive studentore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit është në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimeve në lidhje me njohurite që ofron përmes leksioneve, seminareve e praktikave. Gjatë 1 viti akademik zhvillohen 7 lëndë/module, praktika dhe provimi përfundimtar për të cilat metoda e mësimit dhe vlerësimit është nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve, detyrave të kursit, projekteve, etj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ vlerëson se ky program studimi përdor metoda të përshtatshme që mundësojnë thellimin e njohurive. Njohuritë që merren gjatë leksioneve shqyrtohen/aplikohen në seminare ku studentët zhvillojnë aftësi profesionale. Niveli i njohurive të fituara i lejon studentët të vazhdojnë më tej ciklin e dytë të studimit (MSh) ose ciklin e tretë. GVJ gjithashtu vëren se plani mësimor është në përputhje me udhëzimet e ministrisë së arsimit dhe se kategoritë e lëndëve të programit sigurojnë një zhvillim të aftësive të analitike të studentëve, përtej boshtit kryesor të këtij programi që është studimet rajonale. <i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPMN;</i> <i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i> <i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre,	Siç jemi shprehur edhe në lidhje me kritere të tjera, GVJ konstaton se vlerësimi i jashtëm i përmbajtjes së lëndëve bëhet kryesisht nëpërmjet anketimeve të studentëve. Të dhënat e përfuara nga këto anketime shërbejnë për analizimin e pikave të forta dhe të dobëta të lëndës. Në takimet në institucion, GVJ u informua që syllabuset e lëndëve ri-analizohen në fillim të çdo viti akademik, me qëllim përmirësimin në aspektin e përmbajtjes dhe metodologjisë si dhe rifreskimin e literaturës. Ky është një proces kolegjal dhe i mirë-strukturuar. Bazuar në RVB dhe takimet me studentët dhe stafin akademik, GVJ gjithashtu

<p>si dhe për detyrimet përmblyllëse.</p>	<p>konfirmoi se në përfundim të çdo lënde pedagogu bën përmbledhje të gjithë çështjeve kryesore dhe orienton studentët mbi provimin përfundimtar. Gjithashtu gjatë sezonit të provimeve studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogët për paqartësitë që mund të kenë.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimi, përveçse ndërdisiplinor, është i orientuar për nga praktika, qasje që formëson edhe të gjithë procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve e shkathtësive të studentëve. Kësisoj, procesi mësimor i përshtatet natyrës empirike të programit dhe ofron zhvillim shkathtësishë praktike nëpërmjet projekteve. Po aq e rëndësishme, plani mësimor ka parashikuar praktikën si lëndë më vete, e cila zhvillohet në semestrin e dytë.</p> <p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, bazuar në RVB dhe takimin me studentët, një tjetër element pozitiv përse i përket metodave të mësimdhënies, është përdorimi i diskutimeve në klasë, punës në grup apo detyrave të përbashkëta. Gjatë diskutimeve në klasë, studentët përfshihen në situata hipotetike të marrëdhënive ndërkombëtare ku diskutojnë zgjidhjet e tyre potenciale.</p> <p>Pedagogët aktivisht i motivojnë studentët të marrin pjesë në diskutime dhe të japin mendimin e tyre. Gjithashu ata janë të inkurajuar të shkojnë përtej diskutimeve në klasë duke i paraqitur idetë e tyre në konferenca dhe konkurse studentore apo aktivitete të tjera. Këto aktivitete ndiqen nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës.</p> <p><i>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p><i>https://www.umsh.edu.al/d/170/partneriteti-publik-privat-themeluesi-i-umsh-se-anastas-angjelileksiontehapurper-studentet</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative,</p>	



studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.									
Konkluzione	<i>GVJ vëren se natyra ndërdisiplinore dhe empirike e programti të studimit i mundëson studentëve krijimin dhe testimin e shkathtësive praktike të nevojshme për integrim në tregun e punës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Përbushet plotësisht</td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Siç jemi shprehur edhe më sipër, në përfundim të programit të studimit, për përmushjen e detyrimeve përmbyllëse, diplomimi i studentëve bëhet nëpërmjet temës së diplomës ose provimit të formimit sipas rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Për t'i ardhur në ndihmë studentëve, UMSH ka përgatitur "Udhëzues për provim formimi" i cili i vihet që në fillim të studimeve si dhe publikohen në faqen e web-it të institucionit. Duke qenë që ky program studimi ka një numër të kufizuar studentësh, si provimi si tema ndiqen dhe monitorohen lehtësisht nga stafi akademik. Në vijim të sa më sipër, GVJ konstaton se studentët ndihmohen në mënyrë të strukturuar nga pedagogët për tu përgatitur për temën e diplomës apo provimin. Specifikisht, gjatë sezonit njësia bazë shpall oraret e konsultimeve sipas grup-lëndëve që përbëjnë strukturën e provimit. Provimi është gjithëpërfshirës, dhe mbulon tema të fushave kryesore të programit të studimit të zhvilluara gjatë tre viteve.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i>



<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Evidenca 29. Udhëzues për provimin e formimit</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5ee210c8c94d4.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për studentët e programit të studimit MP në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile ky kriter nuk është i aplikueshëm.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në DVV, RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vëren se provimet korrigjohen nga komisioni ditën e provimit. Kryetari i komisionit të provimit me ndihmën e Koordinatorit të Fakultetit hedh pikët në listën e studentëve pas ç’sekretimit të provimeve, dhe i hedh në sistem brenda 48 orëve. Notat i përcillet studentëve nga koordinatori i fakultetit në bashkëpunim me sekretarinë. Nota e provimit nuk ankimohet sepse është vendim kolegjal i komisionit të provimit. E njehta procedurë ndiqet edhe për temën e diplomës e cila mbrohet para një komisioni të ngritur apostafat.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Për këtë program studimi, në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomën MP në “Marrëdhënie Ndërkombëtare – profili” Në përfundim të studimeve nëse studentët dëshirojnë të tërheqin edhe një kopje zyrtare të programit të studimit, mund të depozitojnë një kërkesë në sekretarinë mësimore, e cila brenda një afati të caktuar ju jep kopjen e kërkuar.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast</p>	<p>Në takimin me zyrën e Sekretarisë Mësimore, GVJ u informua që kjo zyrë është përgjegjëse për hapjen e dosjes personale (fizike dhe elektronike) të studentit që në momentin e</p>

<p>pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>regjistrimit të tij. Pas diplomimit të studentit kjo dosje arkivohet sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 9154 “Për arkivat në RSH”. Një kopje e saj mund t’i vihet në dispozicion studentit në bazë të kërkesës së tij, duke ndjekur procedurat që përcakton Rregullorja e Organizimit të UMSH.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i></p> <p><i>Evidenca 30. Modeli i diplomës për programin MPMN me profile;</i></p> <p><i>Evidenca 31. Modeli i Suplementit të Diplomës për programin MPMN me profile;</i></p> <p><i>Evidenca 32. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Procedurat dhe detyrimet e diplomimit janë të qarta dhe publike. Institucioni ka mekanizmat dhe burimet e duhura për të mundësuar një tutorat efektiv studentëve në përmbushje të detyrimeve përmbyllëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës</p>	<p>Njësia bazë që ofron programin e studimit është përgjegjëse për strukturimin e praktikës profesionale sidomos duke vendosur kontakte me institucione që janë të dobishme për përgatitjen profesionale së studentëve. Kjo praktikë është 3-javore dhe realizohet në fund të programit të studimit, sic është e pasqyruar në planin mësimor. Studentëve i vihet në dispozicion lista e institucioneve me të cilët UMSH ka marrëveshje për praktikën profesionale nga ku zgjedhin. Praktika ndiqet nga një pedagog i</p>

profesionale.	dedikuar për këtë proces i cili sigurohet që procesi të vijojë me sukses. <i>Evidenca 28. Udhëzues për praktikat (Bachelor, Master);</i> <i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky standard nuk është i aplikueshëm pasi në këtë program studimi nuk aplikohen praktika klinike dhe stazhe, por vetëm praktika profesionale. <i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i>
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale synon të familjarizojë studentët me përgjegjësitë dhe kompetencat profesionale që pritet të ushtrojnë. Zhvillimi dhe vlerësimi i praktikës rregullohet me syllabusin dhe udhëzuesin për praktikrat. Studenti vlerësohet në bazë të dosjes së plotësuar dhe me formatet e miratuara nga rektorati. Studenti duhet të dorëzojë e cila kalon për shqyrtim tek komisioni për vlerësimin e praktikës. Dosja e praktikës përmban formatet e vlerësimit nga pedagogu përgjegjës për praktikën, nga personi përgjegjës në institucion, nga vetë studenti si dhe formatin e raportit final. Duke qenë se Praktika është lëndë e programit të studimit MPMN quhet e likujduar nga studenti vetëm pas frekuentimit dhe vlerësimit me notë si dhe ekuivalentohet në 6 ECTS. <i>Evidenca 14. Formularët dhe raporti standard i praktikës;</i> <i>Evidenca 28. Udhëzues për praktikrat (Bachelor, Master)</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni i vë një theks të veçantëpraktiës profesionale nëpërmjet marrëdhënieve të institucionalizuara me partnerët e jashtëm dhe tëtregut të punës duke rritur mundësitë që studentët të integrohen suksesshëm në tregun e punës.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																	
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga analiza e RVB, DVV si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se fakulteti dhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim të përshtatshëm burimesh njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Nga analiza e dokumentacionit, tabelave shoqëruese të RVB, GVJ konstaton se përmbushen kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Nga të dhënat tabelare të vënë në dispozicion nga IAL rezultojnë së Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, ka patur dhe ka në përbërjen e tij stafin si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • 2018 - 2019 : 9 PAE/ 5 PAK • 2019 - 2020 : 11 PAE/ 1 PAK • 2020 - 2021 : 12 PAE/ 4 PAK • 2021 - 2022 : 11 PAE/ 5 PAK Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është si vijon:																																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit</th> <th colspan="2">Viti akademik 2021-2022</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> <th colspan="2">Viti akademik 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti akademik 2018-2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																
Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019																											
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																										

të studimit								
Prof.Dr	2	0	2	0	2	0	2	0
Prof.Asoc	1	1	1	1	0	1	0	1
Dr/PhD	3	2	4	1	5	1	5	1
Msc	0	0	0	0	0	0	0	0
Në total	6	3	7	2	7	2	7	2

Personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me tituj dhe grada shkencore, dhe të gjithë janë me eksperiencë në fushën e mësimdhënies, në shkencat politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Bazuar në tabelat e dorëzuara nga IAL, numri dhe kualifikimi i pedagogëve është i përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore, gjithashtu vlen të theksohet dhe qëndrueshmëria e stafit ndër vite.

Nga evidencat dhe takimet me stafin pedagogjik, GVJ vuri re se stafi inkurajohej të angazhohej në aktivitet kërkimor/shkencor duke marrë pjesë në konferenca dhe botuar aktivitete shkencore. Nga kqyrja e titujve të botimeve u vu re se disa prej tyre ishin botuar në medime të rankuara sipas kërkesave të VKM 112.

Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;

Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Bazuar në tabelat e dorëzuara nga IAL rezulton se stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është si më poshtë vijon:

- 2018 - 2019 : 7 PAE/ 2 PAK
- 2019 - 2020 : 7 PAE/ 2 PAK
- 2020 - 2021 : 7 PAE/ 2 PAK
- 2021 - 2022 : 6 PAE/ 3 PAK

Referuar të dhënave rezulton se ngarkesa mësimore (në orë) mbulohet nga stafi akademik PAE mbi masën 70% në të katër vitet që në

	<p>disponojmë të dhënat. Sipas GVJ, ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj tek PAE dhe PAK dëshmon për një angazhim të personelit akademik për plotësimin e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Nga të dhënat për vitin akademik (Tabela 4), 2021-2022 ngarkesa mësimore e stafi të angazhuar në këtë program studimi varion nga 60 - 210 orë, në të gjitha programet mësimore ku stafi është i angazhuar. Numri i lëndëve që ata mbulojnë është 2 ose 3 dhe janë në përputhje me fushën e tyre të studimit, gjithashtu lëndët janë vazhdim ose thellim i njëra – tjetres. Në CV-të e tyre gjenden ekspriencat dhe kualifikimet e nevojshme që përputhen me fushën e përfshirë në mësimdhënie GVJ vëren se mbulimi i ngarkesës mësimore dhe norma përkatëse respekton raportin PAE/PAK bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 MASR.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga analiza e tabelave shoqëruese të RVB, por edhe nga takime në institucion me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore, vihet re një qëndrueshmëri i qartë dhe e lavdërueshme e stafit akademik përfshirë edhe atë PAK. Nga takimi në zyrën e personelit vumë re që dosjet e personelit ishin të plota dhe që, nga përzgjedhja rastërore, stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi kishte kontrata të rregullta sipas kriterëve ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit</p>	<p>Bazuar në analizën e GVB, DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se procedura e rekrutimit është e mirë-rregulluar dhe e njohur për të gjithë aktorët e institucionit. Kjo procedurë fillon me konstatimin e vakancave nga njësi bazë e cila harton kërkesë për rekrutim stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Në këtë kërkesë, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kadidaturave, të cilat variojnë sipas nevojave të programit të studimit. Kriteret i përcillen zyrës së burimeve njerëzore të cilat pasi përpunohen i përcillen rektorit i cili i miraton. Shpallja e vakancave publikohet në faqen web të institucionit, në rrjete sociale e deri në</p>

<p>dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>televizione dhe periodikë kur është e nevojshme.</p> <p>Për përzgjedhjen, rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit me dy faza. Faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të aplikimeve që janë dorëuar, ndërsa faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi i cila i përcillet rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i rektorit.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 33. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit;</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/277/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në analizën e GVB, DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, siç u shprehëm edhe më sipër, ka angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi. Këto burime njerëzore përmbushin kriteret ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Specifikisht, për këtë program studimi, nuk ka nevojë për personel ndihmës akademik për orë laboratorike.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe specifikisht në zyrën e burimeve njerëzore dhe sekretarinë mësimore, GVJ u njoh nga afër me mënyrën se si ruhej dokumentacioni për këtë program studimi. GVJ vuri re se informacioni në lidhje me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit ruhej në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për programin e studimit. Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila disponon dosjet e plota për çdo personelit. Gjatë vizitës në institucion</p>

<p>dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ nuk evidentoi mangësi në dosjet e personelit akademik.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Duke qenë një MP praktika dhe në tërësi dijet e aplikuara kanë një vlerë të shtuar për këtë program studimi. Siç jemi shprehur edhe për standarde dhe kriteret mbi praktikën, ku program studimi ka një politikë dhe praktikë të mirë-regulluar dhe funksionale. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me aktorë të tregut të punës që mundësojnë praktika të qenësishme dhe punësim potencial pas diplomimit. Praktika ndiqet nga një pedagog i dedikuar (pasi konsiderohet si lëndë me kredite specifike) i cili bashkëpunon me pikën e kontaktit në kompaninë pritëse. Në fund praktika vlerësohet me notë nga pedagogu dhe kompania pritëse. Edhe diploma ndiqet në mënyrë të dedikuar nga udhëheqësi i temës e cila më pas vlerësohet me notë nga komisioni i ngritur për temat e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin</p>	<p>Siç u shprehëm edhe në kriterin 7 më sipër, kompania pritëse ka një person kontakti apo të dedikuar i cili merret me mbarëvajtjen e praktikës dhe në fund vlerësimin e saj sipas formularit të vënë në dispozicion nga IAL. Gjatë gjithë kohës së praktikës, pedagogu që mbulon praktikën mban kontakte të vazhdueshme me të gjitha pikat e kontaktit në kompaninë pritëse për t'u informuar mbi vijimin e punës dhe për të adresuar problematika që mund të lindin gjatë praktikës.</p>

e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	Njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit kanë sasinë e nevojshme të stafit akademik i cili ka formimin e përshtatshëm dhe kualifikimin e kërkuar nga ligji. Ngarkesa mësimore mbulohet në masën 70 % nga PAE dhe stafi akademik ka qëndrueshmëri prej shumë vitesh.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përputhje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe vizitës së ambjenteve mësimore, GVJ konstatoi se kushtet infrastrukturore i mundësonin personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ kryerjen me efektivitet të detyrave të tyre. Mjediset e IAL gjenden në një vendndodhje qendrore në Tiranë e janë lehtësisht të aksesueshme. Zyrat e pedagogëve dhe stafit administrativ ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme. Po aq e rëndësishme, ambientet e IAL mbuloheshin nga me wireless që ofronte internet për stafin dhe studentët. <i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i> <i>Evidenca 24. Relacion i Verifikimit të Godinës</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore të UMSH ishin të përshtatshme pasi ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor. Laboratorët e IT kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës

<p>teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>kërkimore.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i></p> <p><i>Evidenca 24. Relacion i Verifikimit të Godinës</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka laboratorë të pajisur me programe profesionale në përputhje me tipologjinë e programeve të studimit që ofron. Shfrytëzimi i laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve. Specifikisht, ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë specifikë apo të dedikuar.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore të UMSH ishin të përshtatshme pasi ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor. Laboratorët e IT kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës kërkimore.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në dispozicion të këtij programi studimi janë mëse të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Për më tepër, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave të studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përvec anës teorike të mësojnë dhe zhvillojnë edhe atë praktike.</p>

duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.									
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni disponon mjediset mësimore dhe infrastrukturën mbështetëse në dispozicion të programit të studimit për të mundur formimin teorik dhe shkathtësimin praktik të studentëve.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se literatura në gjuhën shqipe në dispozicion të studentëve është e përshtatshme. Duke ju referuar syllabueseve të lëndëve, GVJ konstatoi se lëndët referojnë literaturë të bollshme dhe kryesisht bashkëkohore me tekste mësimore të autorëve të njohur dhe ekspertëve ndërkombëtarë të fushës. Gjithësesi duhet thënë se ka disa raste ku kjo literaturë i përket botimeve të më shumë se 5 viteve më parë. Në diskutimin që u bë me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit në lidhje me plotësimin e kërkesave ligjore për përdorimin e literaturës së 5 viteve të fundit, <i>GVJ sugjeron përditësimin e literaturës së referuar.</i></p> <p><i>Evidenca 10 Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i></p> <p><i>Evidenca 25. Kërkesë për libra DMN</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, u informuam se njësia bazë bënte herë pas here kërkese për tekste dhe burime të tjera të nevojshme. Për këtë program studimi, duke patur parasysh

	numrin e kufizuar të studentëve, nuk ishin paraqitur kërkesa specifike pasi edhe nevoja, sidomos nga studentët, nuk ishin bërë prezente.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV UMSH raporton disponon salla për biblioteka të cilat në tërësi ishin të përshtatshme për lexim e studim. Biblioteka, le të themi qëndrore kishte një hapësirë me rreth 30 poste pune në total nga të cilat 8 poste me kompjutera. Orari i funksionimit të bibliotekë është 8.30 – 20.00. Duke qenë që ky program studimi është me numër të kufizuar studentësh, kufizimi i hapësirës nuk përbën një problem të qenësishëm, por GVJ beson që kur vlerësohen për të gjithë IAL këto janë hapësira të pamjaftueshme. <i>Evidenca 10 Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV UMSH raporton se në bibliotekat e tij gjenden fizikisht gjithsej 4.440 tituj librash në rreth 26.424 kopje gjithsej. Tekstet në bibliotekë janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, kryesisht atë angleze. Bazuar edhe në Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV UMSH raporton analizën e syllabuseve dhe konstatimin në vend nga GVJ, ka hapësirë për shtimin dhe diversifikimin e titujve në bibliotekë. Kësisoj <u>GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e titujve fizikë në bibliotekë.</u> <i>Evidenca 10 Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV UMSH raporton se në bibliotekën online Questia, ku UMSH ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 327.000 tituj librash. Ky fond librash, bashkë me ato që ofron Edward Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, janë në dispozicion të personelit dhe studentëve pa pagesë, në funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të studimit.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të	Gjatë vizitës në institucion, siç u shprehëm edhe më sipër, GVJ konstatoi se në UMSH ofrohet aksesit në Internet pa kufizim nëpërmjet wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në

<p>tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>bibliotekën online. Por, dhe po aq e rëndësishme, në bibliotekë kishte 30 poste pune nga të cilat 8 me kompjutera. GVJ mendon se ky është një numër i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën pavarësisht se programi i studimit nën vlerësim ka një numër të kufizuar studentësh.</p> <p><i>Evidenca 10 Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sipas RVB dhe DVV, salla e bibliotekës së institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të objektivave të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Siç u shprehëm edhe më sipër, biblioteka kishte 8 poste pune me kompjuter dhe 30 poste në total. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 20.00. të cilën GVJ e konsideron të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Sipas RVB dhe DVV, UMSH angazhohet në nxitjen e njërive kryesore dhe bazë që cdo vit të paraqesin kërkesat për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofrojnë. Një pjesë e tujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë edhe botime të personelit akademik të institucionit e cila është një gjë e lavdërueshme.</p>

Konkluzione	<i>GVJ vëren se në tërësi institucioni disponon literaturën e mevojshme dhe mjediset mbështetëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Gjithësesi, <u>GVJ sugjeron</u> që hapësirat e bibliotekës të mund të shtohen dhe tekstet fizike të pasurohen më tej.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UMSH përdor një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me studentët. SMS – Student Management System - mundëson koordinimin efektiv mes stafit akademik dhe atij mbështetës nga njëra anë dhe studentëve nga ana tjetër. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe dhe siç referohet në RVB është funksional që nga dhjetori 2017. Sistemi ka akses të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. Siç u informuam gjatë vizitës në institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroheshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit.</p> <p>SMS përdorej gjerësisht edhe nga stafi administrativ. Të dhënat përditësohen elektronikisht, përveçse mbahen në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Ndërsa, të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar) dhe të gjitha regjistrat në formë të shkruar dhe version elektronik janë në administrimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i></p> <p><i>Evidenca 32. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>SMS është një sistem i cili mundëson administrimin e të dhënave për studentët në kohë reale por jo për veprimtaritë e personelit akademik.</p> <p>Në RVB dhe DVV për këtë kriter nuk u gjenden të dhëna të përdorshme apo referenca të tjera. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se dokumentacioni e aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik apo partnerëve menaxhohen nga zyra e burimeve njerëzore e cila ka një sistem informacioni manual.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe DVV dhe siç u konfirmua gjatë vizitës në institucion, SMS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele akses: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i dedikuar për studentët.</p> <p>Nëpërmjet SMS, stafi akademik mund të realizojë funksione të ofruara nga modulet e sistemit, si psh.: modifikojë të dhënat personale në modulën „profili im“, të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave, të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për cdo lëndë, etj.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare</i></p> <p><i>Evidenca 32. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe DVV dhe siç u konfirmua gjatë vizitës në institucion, SMS mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave të emailit. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se për të menaxhuar në mënyrë efektive procesin mësimor online, sidomos gjatë vitit akademik 2020-2021, institucioni zbatoi edhe platformën G Suite me komponentët e Google Classroom dhe Google Meet.</p> <p>http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe DVV dhe siç u konfirmua gjatë vizitës në institucion, SMS në UMSH mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimin nga ana e studentëve dhe e stafit. Megjithatë, sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në institucion, sistemi nuk mundësonte gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre mbi mësimdhënien.</p>

kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.									
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden në faqen e web-it. Në disa raste, GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për disa mungon një bio e shkurtër prezantuese. <i>https://www.umsh.edu.al/c/4/studimet</i>								
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili është efektiv dhe mundëson një ndërveprim më të zhdërvjellët midis studentëve dhe institucionit në funksion të mësimdhënies e mësimnxënies.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UMSH përcakton në Statut pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare të institucionit ku identifikohen aktorët dhe proceset Specifikisht, baziuar në RVB dhe statut, buxheti hartohet nga administratori i universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe nga propozimet e marra nga njësitë kryesore dhe ato bazë. Më tej buxheti aprovohet nga Bordi i Administrimit i cili, ndër të tjerat, sigurohet që të jetë i realizuar në përputhje me standardet ligjore. Evidenca të detajuara mbi aspekte të ndryshme financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të



<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online dhe datat.</p>	<p>dhënave financiare institucionale.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB kjo gjë ndodh rregullisht. Gjithësesi GVJ nuk ka aftësitë teknike për ta vlerësuar diçka të tillë. Gjithësesi duke qenë një subjekt tregëtar i cili e ka për detyrim ta kryej auditim, GVJ beson që kryet sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 34. Raporti vjetor i institucionit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se kontrolli buxhetor realizohet nga administratori dhe synon përdorimin efikas të burimeve të institucionit, në funksion të arritjes së objektivave. Sipas DVV, detyrë e administratorit është ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të cdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare. Bazuar në analizën e DVV, GVJ konstaton se institucioni ka paraqitur nja plan financiar institucional të krahasuar buxhet kundrejt faktit që nga viti akademik 2018-2029.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH</i></p> <p><i>Evidenca 34. Raporti vjetor i institucionit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni rezulton me fitim. Megjithatë nuk jepen informacione më të plota që të lejojnë GVJ të formojë një opinion të plotë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit.</p>

<p>ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i> <i>Evidenca 34. Raporti vjetor i institucionit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se institucioni ka burimet financiare si dhe procedurat përkatëse – të institucionalizuara në statut – për financimin e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion si dhe nga shqyrtimi i RVB, konstatoi se UMSH ka politika dhe procedura të institucionalizuara të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin në përfundim të ciklit të studimeve. Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MAS.</p> <p><i>Evidenca 2. Plani strategjik i zhvillimit UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të programit MPMN;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësin e Departamentit dhe sidomos GVB, u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi propozohet nga Departamenti. Kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi duhet të plotësojnë kriteret ligjore të cilat lidhen kryesisht me pasjen e një diplome bachelor në një fushë të përngjashme me fushën e studimit të programit.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta</p>	<p>Pavarësisht numrit të vogël të studentëve, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se kriteret e pranimit dhe ecurisë së studentëve përgjatë programit të studimit janë transparente</p>

<p>për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>dhe pjesë përbërëse e dokumentacionit të Institucionit (si Statuti i UMSH apo Rregullorja e Programit të Studimit), te cilat gjithashtu janë publikuar edhe faqen e internetit të UMSH.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/47/formulare-aplikimi</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit</p> <p>https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga analiza e RVB GVJ identifikoi se UMSH harton e publikon çdo vit akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve dhe referon për këtë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Fakultetit. Kriteret e pranimit për programin rishikohen çdo vit nga departamenti në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe janë në përputhje me LALKSH 80/2015, me rregulloren e fakultetit dhe rreguloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, GVJ vëren se UMSH publikon në faqen e internetit udhëzime që lidhen me rregulloren dhe procedurat e pranimit në programin e studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion, sidomos nga takimi me studentët, GVJ vëreu se studentët ishin të mirë-informuar mbi programin e studimit dhe të kënaqur nga niveli i informacionit që i vihej në dispozicion.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në këtë program studimi nuk kishte të regjistruar studentë me aftësi të veçanta apo nga shtesa të marginalizuara pasi edhe numri i studentëve ishte i limituar. Gjithësesi, nga vizita në institucion GVJ u informua se institucioni ofronte bursa ekselence si dhe bursa sociale ku përfshiheshin edhe persona nga shtesa të marginalizuara dhe me aftësi të kufizuara fizike.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në</i></p>

	<i>Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Programi i studimit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe duke mos lejuar kështu regjistrimin e studentëve të huaj.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Siç u shprehëm edhe për kriterin 6 më sipër institucioni ka politika të tilla, por që në këtë program studimi nuk ishin aplikuar pasi nuk kishte patur kërkesa. <i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta dhe të institucionalizuara për përzgjedhjen, pranimin dhe vlerësimin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	N	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e kalimit të studentëve nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e UMSH dhe njësisë bazë që ofron programin të cilat u vihen në dispozicion studentëve. Prezantimi i këtyre rregulloreve zhvillohet kryesisht në javën e parë të vitit akademik që i dedikohet orientimit studentor. Po aq e rëndësishme sekretaria mësimore është në dispozicion gjatë gjithë vitit akademik për të informuar dhe endihmuar studentët në lidhje me orarin mësimor, frekuentimin, datat dhe provimeve. <i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe</i>

	<p><i>Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/73/njoftimi-per-provimet-2020</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/42/kalendari-akademik</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. Duke qenë që ky është njëprogram 1-vjeçar studimi transferimi nuk është i mundur dhe kjo procedurë nuk ka rëndësi të veçantë për studentët.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</p> <p>Evidenca 27. Udhëzues për studentët 2021-2022.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe sidomos syllabuseve, GVJ vëren se kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe bazë si edhe në syllabulls të çdo lënde. Duke qenë se programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të lëndës, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në fillim të çdo semestri.</p> <p>Evidenca 8. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret</p>	<p>Nga analiza e rregullores së institucionit, njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ vëren se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të përcaktohen qartë dhe saktë.</p>

e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Gjithashtu, për t'i ardhur në ndihmë studentëve, institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi provimin e formimit <i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i> <i>Evidenca 29. Udhëzues për provimin e formimit</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ u informua, dhe konfirmua nga takimi me studentët, se në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime me studentët (aktual dhe potencial) për t'i informuar mbi programet e studimit. Këto informacione përcillen, ndër të tjera, përmes panairove, masmedias, si edhe fletëpalosjeve dhe posterave. Të gjitha programet e studimit kanë një koordinator, i cili në bashkëpunim me skeretarinë mësimore mundëson informacion për studentët aktual dhe potencial. <i>Evidenca 15. Broshura e studimeve MPMN</i> <i>Evidenca 35. Rregullore ZKSK</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta dhe të sakta për informimin e studentëve aktual dhe potencial mbi të gjitha elementët e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Siç jemi shprehur disa herë edhe më sipër, informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit fillon që në takimet që zhvillohen me studentët potencialë, me orientimin kur ato aplikojnë, e vijnë gjatë kohës së studimeve. Informacioni mbi strukturën e programit të studimit afishohet gjithashtu edhe në stendat e universitetit, në SMS si edhe në faqen e internetit të UMSH.
Kriteri 2. Institucioni vë në	

<p>dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ-së iu konfirmua që studentët njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit që ditën e parë dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Po aq e rëndësishme, një pjesë e këtij informacioni afishohet fizikisht në ambjentet e institucionit.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/107/fakulteti-i-shkencave-juridike-dhe-marredhenie-nderkombetare</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në nivel institucional, GVJ vëren se UMSH është aktiv në mbështetjen e punësimit të studentëve duke marrë pjesë në panairë, takime me të profilit, etj. Institucioni informon si studentët potencialë dhe aktual mbi mundësitë e punësimit që ofron programi i studimit nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-s, rrjeteve sociale, si dhe takimeve dhe informimeve të kryera nga ZKSK. Nga takimet në institucion GVJ vëreu se për këtë shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucione publike dhe biznese, kompani private dhe me zyrat e punës që synojnë punësimin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 15. Broshura e studimeve MPMN;</i></p> <p><i>Evidenca 35. Rregullore ZKSK;</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga sa kemi thënë më sipër, bazuar në RVB si dhe në vizitën në institucion, studentëve i vihet në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm. Specifikisht, orari mësimor dhe plani mësimor afishohen në ambjentet e fakultetit, si dhe studentët informohen mbi infrastrukturën në funksion të programit të studimit si klasat, biblioteka, laboratorët, hapësirat rekreative, etj.</p> <p><i>Evidenca 15. Broshura e studimeve MPMN;</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/11/njoftime</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/73/njoftimi-per-provimet-2</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/63/stafi-akademik</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të</p>	<p>UMSH zbaton prej vitesh Menaxhimin e Sistemit të Informacionit “SMS” i cili mundëson koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet faqes së UMSH studentët mund të aksesojnë SMS dhe të komunikojnë me pedagogët dhe të shikojnë të dhënat që ata kanë hedhur në këtë</p>

informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	sistem. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin akademik GVJ-së iu konfirmua që çdo pedagog ndjek komunikimin elektronik me studentët. <i>http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta e të institucionalizuara mbi informimin e studentëve për organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ vëren se në nivel institucional UMSH mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në programin e studimit. Specifikisht, sekretaria mësimore mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore. Mbajtja e të dhënave është relativisht e lehtë duke patur parasysh edhe numrin e ulët të studentëve. Referuar të dhënave tabelore (<i>tabela nr. 21</i>) rezulton se numri i studentëve për katër vite akademike sipas profileve është si më poshtë vijon:			
	Mp Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare	Profili Studime Evropiane	Profili Studime Mesdhetare	Mesatarja në hyrje
	2018 -2019	6	0	7.5
	2019 - 2020	6	1	7.7
	2020 – 2021	5	0	8
	2021 - 2022	5	0	7.6

	<p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 32. Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Siç u shprehëm edhe për kriterin 1 është sekretaria mësimore, që regjistron dhe mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, transferuar dhe larguar nga programi i studimit për cdo vit akademik.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore regjistron informacionin (notën) mbi ecurinë e studentëve gjatë programit të studimit deri në diplomim. Të dhënat mbahen elektronikisht dhe në <i>hard copy</i> në regjistrat e notave dhe të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Ndërsa të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin themeltar. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore GVJ vuri re se të dhënat ishin të sakta dhe të mbajtura sipas kërkesave ligjore.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ shkoi edhe në sekretarinë mësimore ku verifikoi me përzgjedhje rastësore disa nga të dhënat të studentëve të programit të studimit me fokus në pasqyrimin e të dhënave personale, numrin e matrikullimit, vlerësimet, etj. Të gjitha këto të dhëna gjenden dhe menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nën kujdesin dhe përgjegjësinë e Sekretarisë Mësimore. Nga sa ishte në gjendje të analizonte GVJ, të dhënat u mbaheshin saktë dhe konform kërkesave ligjore.</p>

saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Evidenca 26. Udhëzues i përdorimit të sistemit SMS <i>http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstaton se njësia bazë ndërmer periodikisht analiza të tilla. Gjithësesi, duke qenë se ky program studimi ka një numër të ulët studentësh, mund të kryhen vetëm 'analiza' deskriptive dhe jo shumë të dobishme. Me vlerë do të ishte një studim mbi arsyet e numrit të ulët të studentëve dhe mënyrave për ta adresuar atë. <i>GVJ sugjeron: që njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës të analizojnë arsyet e numrave të ulët të regjistrimeve dhe të bëjë një plan pune për rritjen e regjistrimeve.</i> <i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe zyra të dedikuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për profilin dhe studentëve të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përishin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në analizën e RVB-së dhe vizitën në institucion, GVJ vuri re se studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht nëpërmjet Këshillit të tyre Studentor. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH. Ky Këshill, bazuar në rregulloren e institucionit, merr pjesë në vendimmarrjen e institucionit dhe konsultohet në mënyrë të strukturuar për të vjelur mendimin e studentëve.

	<p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 35. Rregullore e ZKSK</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në analizën e GVB dhe vizitën në institucion, GVJ evidentoi se studentët përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në klubin e ndryshme, në këshillin e studentëve ku gjenden senatorët e çdo viti dhe programi, si dhe në Senatin akademik. Studentët e pyetur këtë lloj pjesëmarrjeje i thanë GVJ që e dinin që kishte Këshill Studentor por nuk kishin marrë pjesë në aktivitetet e tij.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 35. Rregullore e ZKSK;</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe vizita në institucion, GVJ evidenton se ky program studimi është brenda parametrave ligjore dhe siçomos ngarkesës akademike të studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41.</p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>UMSH aplikon disa metoda për përfshirjen e studentëve me qëllim tërheqjen e mendimit të tyre mbi cilësinë e programit të studimit si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Formularët për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve; ● Mbledhjet e hapura të Departamentit; ● Përmes studentit si përfaqësues në Senat; ● Përmes studentit si përfaqësues në NJSBC; ● Përmes fokus grupeve; <p>Gjithashtu, bazuar në rregulloren e njësisë bazë, studentëve të</p>

	<p>këtij programi ju mundësohet e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve.</p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare</i></p> <p><i>Evidenca 21. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se institucioni ka një politikë të strukturuar për përfshirje kapilare të studentëve në vendimmarrje duke filluar nga Senati akademik e deri tek GVB individuale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ, bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, konstaton se në përputhje të detyrimeve ligjore, UMSH ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK). Një nga detyrat e kësaj zyre është të mbajë kontakte me studentët e programit mbi ecurinë e karrierës së tyre në vijimësi.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL GVJ konstatoi se në realitet zbatimi i këtyre detyrave ishte thuajse i pamundur pasi në program kishte shumë pak student të cilët e vështirësonin ofrimin e këtyre shërbimeve në shkallë. Është shumë e vështirë të krijosh lidhje me biznesit psh, kur në program janë dy deri në katër studentë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin</p>	<p>Po aq e rëndësishme, GVJ konstatoi se për udhëzimet e studentëve kujdesej koordinatori i programit të studimit i cili për shumë nga këto procese shërbente si pikë ndërlidhjeje.</p>

mësimor dhe programin e studimit.	<i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare;</i> <i>Evidenca 11. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera</i> <i>Evidenca 35. Rregullore ZKSK</i>

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sic e thamë edhe më sipër, institucioni ka zyra, rregullore e politika në lidhje me tregun e punës dhe marrjen e të dhënate të punësimit. Gjithësesi për këtëprogram studimi, përpunimi statistikor i këtyre të dhenave dhe ekstrapolimi i përfundimeve specifike është i vështirë pasi numri i studentëve është realisht i ulët. <i>Evidenca 35. Rregullore ZKSK;</i> <i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare.</i>
--	--

Konkluzione *GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta për këshillimin e studentëve dhe lidhjen e tyre organike me tregun e punës*

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e depozituar si dhe takimet gjatë vizitës në institucion, konstatoi se UMSH në zbatim të Ligjit 80/2015 ka ngritur strukturën e NJSBC dhe Zhvillimit të Karrierës reflektuar në statut dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit.</p> <p>Gjithashtu, referuar Statutit të UMSH dhe Rregullores së Përgjithshme, institucioni ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm në funksion të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në kuadër të funksionalizimit dhe institucionalizimit të strukturave të mësipërme dhe të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në tërësi, Senati Akademik ka miratuar Rregulloren e Përgjithshme, Manualin e SBC, Rregulloren e NJSBCZHK si dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në RVB dhe informacionin e përftuar nga vizita në institucion, NJSBCZHK përbëhet nga drejtuesi dhe 9 anëtarë (mandat 3-vjeçar) si dhe 1 student.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p><i>GVJ sugjeron: që IAL të institucionalizojë edhe përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë si një element me vlerë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe lidhjen organike me botën jashtë universitetit.</i></p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH;</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p><i>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK;</i></p> <p><i>Evidenca 10. Përmbledhëse e Tabelave për programin Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: Studime Evropiane/Studime Mesdhetare.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni,</p>	

nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.									
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të institucionalizuara për procedurat dhe njësitë përgjegjëse për promovimin dhe garantimin e cilësisë të cilat janë funksionale..</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë barton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UMSH ka integruar në një njësi Zhvillimin e Kurrikulave dhe sigurimin e cilësisë me arsyetimin që në këtë mënyrë koordinohen më mirë në funksion të monitorimit, mbikqyrjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit.</p> <p>Pas analizës së RVB dhe DVV, GVJ identifikoi evidenca që dokumentojnë punën e NJSBCZHK për çdo vit akademik mbi proceset monitoruese, planveprimin dhe raportin përmbledhës të aktivitetit vjetor si dhe sugjerimet për çdo aktivitet të vlerësuar të programin të studimit.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë	<p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ gjithashtu konstatoi se studentët anketoheshin në përfundim të semestrit para provimit. Po aq e rëndësishme, në pyetësor ka pyetje për të vlerësuar cilësinë e stafit administrativ.</p> <p>Bazuar në takimin që GVJ zhvilloi me pedagogët, NJSBC njofton pedagogun për rezultatet e anketimit si dhe hapat e</p>

e ekspertë të jashtëm.	mëtejshëm të procesit. Ky informacion përfshihet edhe në vlerësimin vjetor të pedagogut dhe dokumentohet në dosjen e tij të punës.			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga evidencat e depozituara në DVV dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, duket se ky proces është institucionalizuar dhe rutinizuar. Gjithësesi, mbetet me rëndësi që të mos transformohet në një ushtrim formal, por të ruajë karakterin substancial pasi është thelbësor.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Gjithësesi, dhe po aq e rëndësishme, bazuar në analizën e RVB-së si dhe vizitën në institucion, GVJ vëren se në tërësi pesha kryesore e proceseve të mësipërme bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të zbatuar masat organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor. Duke qenë që puna 'reale' kryhet nga njësitë bazë dhe kryesore duket sikur NJSBCZHK, e cila teorikisht është njësi e posaçme ngritur nga IAL për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrë dhe rishikur programin e studimit, është jashtë loje nga pikpamja përmbajtësore.			
	<i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i>			
	<i>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK;</i>			
	<i>Evidenca 20. Plan pune i NJSBC për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2021-2022</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka krijuar dhe zbatuar në mënyrë kapilare procedura të dedikuara e publike për sigurimin e bendshëm të cilësisë. Informacioni i siguruar nga këto struktura i përcillet drejtuesve të cilat i përdorin për të përmirësuar politikat e brendshme dhe orientuar burimet mbështetëse. GVJ gjithashtu vëren se barra kryesore e këtyre procesve bie mbi njësinë bazë duke anashkaluar NJSBCZHK-në</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBCZHK prodhon raporte analitike të cilat përfshijnë sugjerime të studentëve nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, sondazheve e fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve.</p> <p>Këto analiza përdoren nga drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore për të monitoruar cilësinë, ndërhyrë kur është e nevojshme dhe promovuar një kulturë cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm.</p> <p>Në këtë kuadër, një rol të veçantë në sigurimin e cilësisë luan edhe vlerësimi nga palë të treta të fushës përkatëse nga sektori publik dhe privat. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në raport janë kryer takime/intervista me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Në tërësi, për vlerësimin e programit të studimit, NJSBCZHK përdor instrumenta të drejtpërdrejta dhe të tërthorta përcaktuar në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Instrumentet e përdorura përfshijnë pyetësorët me studentët; fokus grupet; pyetësorë për pedagogët; takimet e përbashkëta me pedagogët dhe departamentet; dhe intervista me studentët; takime me stafin administrativ. Gjithashtu, njësia bazë zhvillon analizën vjetore për çdo vit akademik ku trajton me detaje ecurinë e programeve të studimit dhe ndërhyrjet potenciale në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion dhe takimet me aktorët e brendshëm e të jashtëm të lidhur me programin e studimit, GVJ konstaton përfshirjen e aktorëve të brendshëm në strukturat e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit. Në strukturën e NJSBCZHK janë përfshirë anëtarë përfaqësues të njësive kryesore, kurse në GVB janë përfshirë dhe përfaqësues të studentëve.</p> <p>Në funksion të sigurimit të cilësisë institucioni përfshin palë të treta si ekspertë të diplomacisë dhe marrëdhënies rajonale si një element të rëndësishëm. Në lidhje me studentët, IAL i ka përfshirë në Senatin Akademik dhe Komisionin e Përhershëm për</p>

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë kryesore, programeve të studimit, garantimit të cilësisë dhe marrëdhënieve me studentët, me synim që zëri i tyre të dëgjohej nga institucioni.

Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK;

Evidenca 17. Formulari i studentit Alumni;

Evidenca 21. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti;

Evidenca 23. Procedurat e punës me fokus grupet.

Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni monitoron periodikisht cilësinë dhe i përdor këto të dhëna për të adresuar problematikat e identifikuara dhe replikuar praktikat e mira.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Senati Akademik ka miratuar aktet e nevojshme në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion. Siç jemi shprehur edhe më sipër, disa nga aktet më të rëndësishme janë: Manuali i SBC dhe Rregullorja e Përgjithshme ku përcaktohen, ndër të tjera, ngritja e GVB dhe përfshirja e përfaqësuesve të studentëve, stafit akademik dhe atij ndihmës-akademik.</p> <p>GVJ, pas shqyrtimit të Manualit të SBC, konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në NJSBC nuk ka asnjë përfaqësim nga aktorë të jashtëm si punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës; • Cikli i vetëvlerësimit të brendshëm të cilësisë është një herë në 6 vjet.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Referuar këtyre dy konstatimeve, dhe siç u shprehëm edhe më sipër, <i>GVJ konkludon se IAL nuk ka përfshirje të strukturuar të aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> GVJ gjithashtu mendon se cikli 6-vjeçar i vetë-vlerësimit të brendshëm mund të jetë shumë i gjatë duke patur parasysh dinamikat e arsimit të lartë, sidomos të këtij programi studimi i cili vuan në mënyrë kronike për studentë.</p> <p><i>Evidenca 13. Manuali i NJSBCZHK;</i></p> <p><i>Evidenca 22. Programi i trajnimeve 2020-2021.</i></p>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore,	

<p>përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka politika të qarta për promovimin dhe sigurimin e cilësisë si dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm të IAL në këtë proces. GVJ gjithashtu konstaton se më shumë duhet bërë për përfshirjen e strukturuar të aktorëve të jashtëm në këto procese.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e

studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe njësi të dedikuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas kërkesave ligjore. Nga vizita u konstatua që raportimi në RVB përputhej me situatën reale. Pegadogët bënë vetëvlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, të dhënat përpunoheshin dhe problematikat e identifikuar përcilleshin dhe adresoheshin në instancat e përshtatshme.</p> <p>GVJ konstatoi se, në organikën e UMSH është zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave me detyrë të monitorojë dhe promovojë cilësinë si dhe të identifikojë problematikat e ndryshme dhe të koordinohet me instancat përgjegjëse për adresimin e tyre. IAL, dhe njësitë përgjegjëse, i kushtonin rëndësi sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe merrnin masa që të promovonin cilësinë në çdo hallkë të proceseve që lidheshin me këtë program studimi.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar në analizën e RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vëren se njësia përgjegjëse për kontrollin e brendshëm të cilësisë kryen dy anketime në vit për të gjitha lëndët në të dy semestrat e vitit akademik. Anketimet zhvillohen në fund të semestrit përpara se <u>studenti të marrë notën</u>. Të gjithë studentët që janë të pranishëm në klasë marrin pjesë në anketim rezultatet e të cilit përpunohen nga zyra e sigurimit të cilësisë. Të dhënat përfshihen në një raport vjetor i cili nuk përmend emra por identifikon tematika të rëndësishme të cilat më pas bëhen pjesë a planit të punës për njësitë bazë dhe të njësisë së kontrollit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/11/njofitime</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vëren se rezultatet e vlerësimit i përcillen zyrës së burimeve njëzore,</p>

shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	drejtuesve të njësive bazë dhe kryesore ku prezantohen gjetjet në rang njësie dhe problematikat e tjera në nivel pedagogu. Këto të dhëna pasi përpunohen, përcillen në zyrën e burimeve njerëzore dhe bëhen pjesë e një dosjeje e cila përfshin vëtvlerësimin e pedagogut, vlerësimin e dekanit/shefit të departamentit si edhe pyetësorët e studenteve. Bazur në të gjitha këto gjetje të strukturuar në një dosje vlerësuese, drejtuesit e njësive bazë zhvillojnë takime me pedagogët për të identifikuar mënyrat më të mira për të zgjidhur problematikat e hasura.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se në fund të cdo viti akademik anëtarët e stafit akademik plotësojnë një formular vëtvlerësimi ku ato prezantojnë produktet e tyre akademike si dhe një plan pune për vitin e ardhshëm. Raporti shqyrtohet nga drejtuesi i njësive bazë, dekani dhe më pas zyra e burimeve njerëzore. Në fund të këtij procesi pedagogu zhvillon një takim me zyrën e burimeve njerëzore ku identifikohen pikat e forta, të dobëta dhe finalizohet plani i vitit pasardhës. <i>https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</i> <i>https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Ky program studimi, duke qenë që ka pak studentë, i përthith këto veprimtari me ato të programeve të tjera të studimit që ofron njësia bazë. Gjithësesi, siç u shprehëm edhe më sipër, ka një proces të strukturuar të promovimit dhe përmirësimit të cilësisë. Për pedagogët, takimet me zyrën e burimeve njerëzore si dhe takimet periodike të njësive bazë janë instrumentat kryesorë të veprimtarive periodike dedikuar sigurimit të cilësisë. Studentët gjithashtu përfshihen, ndër të tjera, nëpërmjet mbledhjeve të hapura ku mund të marrin pjesë studentët.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni zhvillon procese dhe veprimtari të cilat janë publike dhe në tërësi efikase për krijimi dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës VI		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: a. Studime Mesdhetare; b. Studime Europiane

a. Pika të forta dhe afirmime:

- 1) Programi ka një numër të lartë pedagogësh me eksperiencë profesionale në diplomaci ndërkombëtare dhe rajonale. Kjo i jep mundësi studentëve të MP që të përftojnë dijet e duhura dhe të krijojnë një rrjet profesional për të ardhmen e tyre;
- 2) Marrëveshjet dy dhe shumë-palëshe me institucione akademike dhe profesionale i krijojnë mundësi studentëve që të bëjnë praktika profesionale me cilësi dhe të kenë kontakt me tregun e punës që në bankat e shkollës;
- 3) Proceset e mirë-strukturuara të kontrollit dhe promovimit të cilësisë krijojnë një ambient mundësues si për stafin ashtu edhe për pedagogët;

b. Pika të dobëta:

- 1) Numri i ulët i studentëve e bën të vështirë aplikimin efektiv të tërësisë së metodave të mësim-dhënies; (*Standardi V.4, kriteri 5*)
- 2) Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë nuk përfshin në mënyrë të strukturuar aktorët e jashtëm të interesuar në programin e studimit; (*Standardi VI.1*)

Rekomandime:

- 1) Përditësimin e literaturës së referuar në syllabuse si dhe shtimin e titujve fizikë në bibliotekë;
- 2) Në bashkëpunim me zyrën e karrierës, njësia bazë të analizojnë arsyet e numrave të ulët të regjistrimeve dhe të bëjë një plan pune për rritjen e regjistrimeve;
- 3) Institucioni të institucionalizojë përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë si një element me vlerë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe lidhjen organike me botën jashtë universitetit;

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in
"International relations with profiles: a. Mediterranean Studies; b. European Studies"**

a. Strengths and affirmations:

- 1) There are many lecturers in this program, some full time and some part time, who have extensive professional experience in international and regional diplomacy. This feature enables students to gain the required knowledge for their chosen topic of study and create their future professional network;
- 2) The bilateral and multi-lateral agreements the university has with professional and academic institutions provides students with opportunities to undertake diverse practices that can be useful to them professionally;
- 3) The well-structured processes of internal quality control and promotion create a positive enabling environment for lecturers and students alike;

b. Weaknesses:

- 1) The low number of students hinders the effective application of various teaching methods;
(*Standard V.4, criterion 5*)
- 2) The internal quality assurance system lacks a structured involvement of the external actors interested in the study program; (*Standard VI.1 criterion 1*)

Recommendations:

- 1) To update the required reading literature and to add and enrich the physical books available in the university library;
- 2) In cooperation with the career office, the basic unit should analyze the reasons for the low number of students and establish a work plan to increase the number of students;
- 3) The institution should institutionalize the inclusion of external experts in the internal quality assurance system as a valuable instrument for the continuous improvement of quality and the organic connection with the outside world;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përbushjes	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X